



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office of
the Chief State Prosecutor

AD.nr. 08/2024
Dt. 20 Shtator 2024
Prishtinë

Në kuptim të nenit 9 par.1,nënpar.1.4 lidhur me par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057), në lidhje me ankesën e karakterit disiplinor të palës: [REDACTED] të dt.20.08.2024, në raport me [REDACTED] e Prokurorisë Themelore në [REDACTED], pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve të palës ankuese në fjalë, unë si autoritet kompetent, nxjerr si në vijim këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e palës: [REDACTED] e dt.20.08.2024, në raport me [REDACTED] e Prokurorisë Themelore në [REDACTED] lidhur me pretendimet që i njëjti të mos ketë qenë në nivelin e trajtimit objektiv e profesional me rastin e nxjerrjes së vendimit refuzues të një kërkesë për përjashtimin e prokurorit të çështjes [REDACTED] nga rasti penal: PP/II.nr.337-2/23 i dt.26.06.2024 si dhe refuzimit të ankesës disiplinore po të njëjtës palë ndaj prokurorit të shtetit të sipër cekur sipas vendimit:AD.nr.5/2024 të dt.26.06.2024, ngase pretendimet e tilla ankimore nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje të mundshme disiplinore në referencë me [REDACTED] e Prokurorisë Themelore në [REDACTED] ashtu siç janë të përcaktuara në nenin 6 par 1 e par 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057).

A r s y e t i m

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit - U.D. Kryeprokurori i Shtetit, më dt.27 Gusht 2024, nga Kryesuesi i KPK-së, z.Ardian Hajdaraj, përmes aktit përcjellës: KPK.nr.899/2024 të dt.27.08.2024, ka pranuar për trajtim parashtrësën-ankesën e karakterit disiplinor të palës: [REDACTED] ndaj [REDACTED] të Prokurorisë Themelore në [REDACTED], me pretendimet që të ketë bërë shkelje të natyrës disiplinore si pasojë e mostrajtimit profesional dhe objektiv të një kërkesë për përjashtim të prokurorit të shtetit pranë zyrës së tij [REDACTED] si dhe ankesës disiplinore të njëjtës palë në raport me

prokurorin e sipër cekur, rast ky i trajtuar sipas aktvendimit PP/II.nr.337-2/23 dt.26.06.2024 dhe vendimit AD.nr.5/24 dt.26.06.2024.

Kronologjia e fakteve të rastit:

-Në kontekst të shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesën e sipër cekur të palës ankuese në fjalë, Unë si autoritet kompetent, në kuptim të dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.4 dhe par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057), kam ndërmarrë veprimet e parashikuara ligjore në raport me [REDACTED] e Prokurorisë Themelore [REDACTED] [REDACTED] ashtu që sipas shkresës zyrtare: AD.nr.08/2024 të dt.29 Gushtit 2024, kam kërkuar raport të detajuar me shkrim rreth statusit-epilogut të trajtimit të atyre çështjeve të sipër cekura në të njëjtën prokurori nga ana palës ankuese [REDACTED]

-Në ndërkohë, më dt.06 Shtator 2024, nga [REDACTED] i Prokurorisë Themelore në [REDACTED] lidhur me çështjen e kërkuar si më lart kam pranuar raportin-njoftimin e detajuar me shkrim me nr. Reference PP/II nr.337-2/2023 të dt.06.09.2024, rreth ecurisë dhe statusit të trajtimit të atyre çështjeve të pretenduara nga pala ankuese e sipër cekur.

-Pas analizimit dhe shqyrtimit në mënyrë të gjithanshme të gjitha rrethanave faktike të kësaj çështjeje disiplinore e në korrelacion me pretendimet e palës ankuese në fjalë, kam arritur në përfundimet si në vijim:

-Nga përmbajtja e raportit-njoftimit të sipër cekur me shkrim të [REDACTED] të Prokurorisë Themelore në [REDACTED] rreth ecurisë së trajtimit të asaj çështjeje pretenduese nga ana e palës ankuese [REDACTED] rezulton se në kuadër të autorizimeve të përcaktuara ligjore ish-Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në [REDACTED] duke iu përmbajtur të gjitha parametrave profesional e ligjor të ketë nxjerrë aktvendimin për refuzimin e kërkesës së palës ankuese në fjalë për përjashtim të prokurorit të shtetit [REDACTED] nga lënda penale, PP/II.nr.337-2/2023 të dt.26.06.2024.Për më tej shtoj faktin se në të njëjtën çështje procedurale penale nga prokurori i çështjes [REDACTED] ishin ndërmarrë një mori veprimesh procedurale penale ku e njëjta çështje akoma është aktive dhe nuk ka marrë epilog ngase prokurori i çështjes në fjalë është në pritje të sigurimit të një ekspertize-mendimi profesional nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

-Përkundër kësaj, Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse nuk ka autorizime ligjore që të ndikoj tek një prokuror i shtetit që e ka nën varësi lidhur me aspektet e të vendosurit në një lëndë të caktuar penale, rrethanë kjo e bazuar në nenin 21 par.1 nënpar.1.8 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr.08/L-167, në mënyrë të qartë është parashikuar se “Kryeprokurori mund tu jap udhëzime me shkrim prokurorëve të një prokurorie që udhëheq me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit, mirëpo udhëzimet e tilla duhet të jenë të arsyetuara dhe nuk duhet të cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve”. Rrjedhimisht udhëzimet e tilla nënkuptohet se nuk duhet të përmbajnë referime për sa i përket kualifikimit të veprës penale, metodave të hetimit dhe mbledhjes së provave si dhe arsyetimit të hetimit dhe aktakuzës”.

Për më tej sipas nenit 8 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr.08/L-167, janë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit ku përfshihet se të njëjtit gjatë “ushtrimit të funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit”.

Kështu në raport me pretendimet e palës ankuese [REDAKTUAR] se subjekti në fjalë i këtij rasti disiplinor kinse të ia kishte shkelur të drejtat ligjore sa i përket mos mbikëqyrjes së punës të prokurorit të shtetit në kuadër të zyrës së tij rreth trajtimit objektiv e profesional dhe me efikasitet të rastit të sipër cekur penal, konsideroj se të njëjtat pretendime janë të pa mbështetura në ndonjë fakt relevant.

Prandaj, pretendimet e palës ankuese në fjalë në raport me [REDAKTUAR] e Prokurorisë Themelore [REDAKTUAR] lidhur me çështjet e sipër cekura, konsistojnë kryesisht në vlerësimin e tij të lirë. Kjo për arsye se nga gjendja e fakteve të elaboruara si më lartë, rezulton qartë se subjekti i kësaj ankese: [REDAKTUAR] i Prokurorisë Themelore në [REDAKTUAR], me asnjë nga veprimet e tija nuk kishte kryer ndonjë nga shkeljet e natyrës disiplinore apo profesionale, përkundrazi i njëjti subjekt iu kishte përmbajtur të gjitha kritereve të parashikuara ligjore, profesionale dhe etike në trajtimin e kërkesave të ndryshme po të kësaj pale ankuese.

Andaj, duke u bazuar në atë që u theksua më sipër, kam konsideruar se pretendimet e palës ankuese: [REDAKTUAR] nuk ndërlidhen me asnjë nga rrethanat e parashikuara ligjore që paraqet shkelje të natyrës disiplinore ashtu si që janë të përcaktuara në nenin 6 par 1 e par 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057), dhe për këtë arsye kjo çështje ankimore-disiplinore konsiderohet e mbyllur: A.A.



Besim Kelmendi
U.D.Kryeprokurori i Shtetit